

# FLEXOCEM BARDH/GRI

## MIKROSOLUCION MBROJTES PAPERSHKUES

### Karakteristika

**FLEXOCEM** është një solucion çimentor prej dy përbërësish me bazë lidhësash hidraulikë, inertesh të përzgjedhura dhe shtesash specifike (përbërësi A) dhe rrëshirash elastomerike të përziera (përbërësi B). Duke përzier dy përbërësit krijohet një përzierje që punohet mirë; ngjeshje optimale mbi të gjitha sipërfaqet prej betoni dhe muratura; lehtësisht e aplikueshme edhe me spatul edhe vertikalisht, deri në 2 mm trashësi me një dorë të vetme.

Me t'u lyer krijon një veshje të hollë dhe elastike e të papërshkueshme nga uji, CO<sub>2</sub> dhe SO<sub>2</sub>, rezistente ndaj ngrirjes dhe veprimit të kriprave shkrirëse tepër agresive edhe për betonin e cilësisë së lartë.

### Fusha e përdorimit

**FLEXOCEM**, mbrojtje elastike dhe e papërshkueshme për të gjitha sipërfaqet e betonit (shtylla dhe skela rrugore, parete të jashtme në përgjithësi), suvatë dhe gurishte të çimentuara; rekomandohet dhe për papërshkueshmëri në shtytje pozitive të parkimeve nëntokësore, vaskat për mbajtjen e ujit dhe substancat pak agresive, konduktorët, pishinat si dhe për veshjen dhe shtrimin e tarracave të vogla.

### Përgatitja e sipërfaqeve

- Sipërfaqet, duhen të jenë të staxhionuara, solide, të qëndrueshme, pa papastërti a pluhur. Duhet të hiqen gjurmët e vajrave, yndyrërave, muqeve, pjesë që janë duke u shkëputur apo që nuk janë të kapura mirë. Të bëhet me kujdes një pastrim i betonit duke hequr pjesët e prishura apo që janë duke u shkëputur, derisa të arrihet tek një nënshtresë solide, e qëndrueshme dhe e dorës së parë.
- Të meta, të ngritura mbi 2 mm apo pjesë të degraduara duhen rindërtuar ose riparuar më parë.
- Të aplikohet mbi sipërfaqe të njomura por pa mbetje uji.

### Përgatitja e solucionit (Ilaç)

- Hidh një enë me përbërës B (lëng) në një enë të pastër dhe shto duke përzier një enë me përbërës A (pluhur).
- Përziej me kujdes dhe ngadalë për disa minuta, derisa të arrihet të krujosh një tretësirë homogjene e pa kokrriza, duke pasur kujdes të heqësh nga paretët dhe nga fundi i enës atë pjesë të pluhurit që nuk është shpërndarë si duhet.
- Për të përzier përdor një përzierës mekanik (trapon me shufër) me numër të vogël rotullimesh për të shmangur një sasi të tepërt ajri të futur në këtë përzierje.
- Mos e përgatit me dorë këtë përzierje.

### Mënyra e përdorimit

- Këshillohet të përdoret brushë për një dorë të parë të hollë sa për të kapur me një raport përzierjeje A+B=2.5:1 duke u përpjekur që të mbulohet MIRE e gjithë sipërfaqja e duhur. Të paktën pas 5 orësh (në 20° C) të procedohet me spatul ose brushë me një trashësi maksimale 2mm për shtresë, duke pritur nga një dorë në tjetrën kohën e nevojshme për forcimin e dorës së mëparshme.
- Në rastin e përdorimit të spatulës në përgatitjen e solucionit, do të përzihet përbërësi A (pluhur) me atë B (lëng) derisa të arrihet një mishelë e përshtatshme (raporti A:B=3:1 afërsisht).
- Në rast aplikimi mbi sipërfaqe me të çara të vogla apo mbi struktura shumë të deformuara, këshillohet që mes dorës së parë dhe të dytë të vihet një rretë përforcuese (me gramaturën e duhur) me fibra xhami ose sintetike, alkaline-rezistente. Kujdes! **FLEXOCEM** nuk mund të përdoret mbi sipërfaqe të lagështitura ose me prurje uji, prandaj blloko qysh më parë depertimet e ujit me MICROBLIC. **FLEXOCEM** nuk mund të përdoret për shtysë negative.

**V.R!** Mos shto ujë, lëndë inerte apo lidhës (çimento, gëlqere, allçi etj)

## Të dhëna teknike dhe aplikuese

Përbërësi A	
Pamja	Pluhur ngjyrë gri/bardh
Thërrmimi	0-0.6 mm
Ambalazhi	Thes 18 kg
Përbërësi B	
Pamja	Lëng i bardhë
Vëllimi	Rreth 1.03 kg/l
Ambalazhimi	Enë 6kg
Raporti i përzjerjes (A+B)	3:1 fortësi plastike (me spatul)
Koha e përzjerjes (trapon 300 rrot/min)	2.5:1 dendësi gjysmë – lëng (pa brushë) Rreth 3 min
Pesha specifike e llaçit të freskët	Rreth 1.650 kg/m <sup>3</sup>
Koha e përdorimit (Pot Life 20° C, 60% U.R)	rreth 30 min
Temperatura e përdorimit	nga +5 deri në +30° C
Trashësia maksimale për një dorë	2 mm
Koha mes dy duarve (20° C)	Rreth 5 orë
Rezultatet përfundimtare	
Njeshja për beton (pas 28 ditësh)	1.8 N/mm <sup>2</sup>
Konsumi	1.65 kg (A+B)/m <sup>2</sup> për mm trashësi

**V.R!** Të dhënat e mësipërme u referohen provave laboratorike në lagështi dhe temperatura konstante. Këto mund të ndryshojnë në vartësi të sipërfaqeve mbajtëse e të kushteve termoigrometrike të kantierit.

## Paralajmërime

- Mbushja e vaskave, pishinave dhe e tubave mund të bëhet vetëm pas 3-4 ditësh që nga aplikimi.
- Shmang prurjet e ujit brenda 3 ditëve
- Mos kryej mbushje me trashësi më të madhe se 2 mm për dorë
- Mos i shto produktit e mos e hollo, koha e përdorimit të llaçit është rreth 30 min në 20° C, pastaj përgatit vetëm sasinë që mund të aplikohet brenda kësaj kohe
- Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira, në fazë shkrirjeje apo në rrezik ngrirjeje brenda 24 orëve të ardhshme
- Mos e përdor në pishë të diellit mbio sipërfaqe tejet të nxehura dhe kur frynë shumë erë.
- Të mbrohet nga shiu te paktën 6 orë nga aplikimi.
- Mos shto ujë, lëndë inerte apo lidhëse (çimento, gëlqere, allqi, etj).
- Të gjitha pjesët e ekspozuara nga jashta duhet të mbrohen nga avullimi dhe staxhionimi për të paktën dy ditë.

**V.R.!** Përbërësi B nuk duhet nxjerrë në diell, por duhet ruajtur në një vend të freskët, dhe jashtë rrezikut nga ngrirja. I ruan vetitë e tij karakteristike për 12 muaj, nëse mbahet në ambalazhimin origjinal. Po e njëjta kohë ruajtje për pjesën A (pluhur), po të mbahet në vend të freskët dhe në ambalazhimin origjinal të pahapur.